

PRANUAR MË: 16.11.2022
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/552



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 14.11.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 40 paragrafi 2 pika d, nenit 53 paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 10, nenit 19 dhe nenit 28, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e –tetë- (tetë) të rregullt të mbajtur me datë: 10.11.2022 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2022


- 1.Miratohet Draft Plani i punës nr.02/517 datë:01.11.2022 i Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2022.
- 2.Draft Plani i punës për vitin 2022 përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e përcaktuar nga Komiteti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Draft Plani i punës për Komitetin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit, përmes Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës
Anëtarëve të Komitetit





PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 01/11/2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/517



Republika e Kosovës
Kuvendi i Komunës në Malishevë
Komiteti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

DRAFT PLANI I PUNËS
Për vitin 2022

Duke u mbështetur në vendimin nr.02/164 të datës 04.04.2022 të Kuvendit Komunal në Malishevë për formimin e Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kemi përgatitur draft planin e punës për vitin 2022.

Komiteti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përbëhet nga pesë (5) anëtarë : 1. Valon Mazreku, 2. Diellza Kryeziu, 3. Valon Krasniqi, 4. Sadik Vrenezi dhe 5. Shefki Krasniqi.

Në këtë plan kemi paraqitur aktivitetet që do të realizohen gjatë këtij viti në mënyrë kronologjike, si pas tabelës në vijim:

TABLEA E AKTIVITETEVE

Nr.	Aktiviteti	Përiudha e realizimit	Qëllimi
1	Mbledhja e Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2022	Tetor	Miratimi i planit të punës nga Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
2	Mbledhja e Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 1. Takimi me Drejtorinë e Bujqësisë në Malishevë.	Nëntor	Informimi për gjendjen e Bujqësisë në Komunën e Malishevës

3	Mbledhja e Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: 1. Takim me Shoqatat e Bujqësisë në Komunën e Malishevës	Nëntor	Informimi me kushtet dhe gjendjen momentale të sektorëve të ndryshëm të Bujqësisë në Komunën e Malishevës si dhe shqyrtimi i mundësive për mbështetjen e bujqësisë nga donator të ndryshëm
4	Mbledhja e Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: 1. Vizita në terren.	Nëntor	Vizita në terren për tu informuar me kushtet dhe gjendjen momentale të sektorëve të ndryshëm të Bujqësisë në Komunën e Malishevës
5	Mbledhja e Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: 1. Takim me IADK-në	Dhjetor	Informimi nga IADK për mbështetjen e Bujqësisë në Komunën e Malishevës
6	Mbledhja e Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. 2. Hartimi i planit të punës për vitin 2023.	Dhjetor	Shqyrtimi i raportit të punës së komitetit për gjendjen e Bujqësisë, sfidat, planifikimi buxhetor i drejtorisë.
7	Raportimi i Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Kuvend.	Dhjetor	Raportimi i Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuvend.

Datë: 28.10.2022

Malishevë

Kryesuesi i Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Valon Mazreku

